



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202002013/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Krujë*

Drejtuar: **Kryekomisar Artur HEBAJ**
Shef i Komisariatit të Policisë Krujë

KRUJË

Për djeni: **Drejtues i Parë Lorenc SHEHU**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

DURRËS

I nderuar z. Hebjaj

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar,¹ bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Krujë.

Inspektimi u krye në datën 23.06.2019, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, dhe z.Besnik Deda me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", në "Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", dhe në "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

¹ Neni 81 i Ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"

Shënime të përgjithëshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Rendit të Komisarariatit të Policisë Krujë z. Fatos Tresa, të cilin e vuri në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit. Ai dhe punonjësit e tjerë të policisë të cilët u kontaktuan, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit.

Pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me inspektimin, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Gjatë inspektimit të zyrave të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Krujë, nuk u konstatuan sende apo mjete të cilat mund të ekspozonin dhunë apo elementë për trajtim çnjerëzor dhe denigrues.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezulton se:

- Ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në ambientet dhe mjediset në të cilat do të merren në pyetje shtetasit e shoqëruar.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

- Nuk ishin zbatuar rekomandimi për rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Krujë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standard bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin dhe vënien në funksionim të dhomës së tretë të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Krujë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Procedurave Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe dinjitoz për të shoqëruarit.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e tualeteve për personat e shoqëruar brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimin për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarariatit të Policisë Krujë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika të cilat do paraqiten konkretisht më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Krujë ambientet e shoqërimit nuk ishin realizuar plotësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Procedurat Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, ku specifikohet se *“ato duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”*.²

Në këtë Komisariat kishte vetëm 2 (dy) dhoma shoqërimi, 1 (një) për meshkujt madhorë dhe tjetra e përbashkët për femrat dhe të miturit, brenda ambienteve të Komisarlatit por të ndarë nga kodina e këtij institucionit. Dhomat kishin nga një dritare, e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, të lyera dhe ishin të pajisura plotësisht me orenditë e nevojshme, si tavolinë e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Këto ambiente ishin me sipërfaqe 3x4m² me hapësirë të pamjaftueshme për qëndrimin e personave të ndaluar apo arrestuar. Sipas informacionit të dhënë qëndrimet në këto ambiente ishte deri në 6 shtetas të shoqëruar në konflikt me ligjin.

Gjithashtu, referuar rekomandimit të Komitetit Europian për Parandalimin e Tortuës (CPT), në pikën 8 të rekomandimit citohet se: Të mos mbahen e personat e arrestuar / ndaluar në ambiente / dhoma që janë më pak se 5m².

Dhomat e shoqërimit nuk ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij komisarlati. Në korridorin dhe në dhomat e ambienteve të shoqërimit ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve, që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Në Komisarlatin e Policisë Krujë, gjatë periudhes 01.01.2020 deri më 23.06.2020, ishin të shoqëruar dhe evindetuar në rregjistër të shoqërimit 50 shtetas, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122/1 të ligjit për Policinë e Shtetit.

Gjithashtu në dhomat e shoqërimit nuk kishte sende apo mjete të tilla që shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Grupi i punës u informua nga drejtuesit e komisarlatit, në lidhje me masat të marra me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19, ishin të pajisur me maska, dizinfektues të sjellë nga drejtoria. Në kuadër të masave, me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ishte vendosur edhe rregulli për të shmangur sa më shumë shoqërimet e shtetasve në komisarlate, por të kryheshin verifikimet në terren. Emrat e personave të infektuar shpërndahen nëpër komisarlate sipas vendbanimeve dhe monitorohen nga inspektorët e zonave kryesisht përmes telefonatave, duke u rikujtuar respektimin e rregullave të karantinimit.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

² Kreu VI, pika 3 e Procedurave Standarde.

Në Komisarlatin e Policisë Krujë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë në Komisarlatin të Policisë Durrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Krujë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Procedurat Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit nuk ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar vendosej momenti i arrestimit/ndalimit në vendin e privimit të lirisë, në çdo rast ky orar shërben dhe në momentin e hyrjes së personave në Komisarlatin e Policisë Krujë dhe ky orar shërben edhe në procedurat që ndiqen lidhur me arrestimin e personave kur ekzistojnë kushtet që urdhërohet arrestimi i tyre.

Në këtë Komisarlat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga verifikimi i këtij regjistri, rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Sipas punonjësve të policisë nuk ka pasur ankesa apo kërkesa që të evidentoheshin në regjistrin e mesipërm.

Mjediset e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Krujë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit, në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit³.

³ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar

Nga monitorimi që u bë zyrtarisht të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë, kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore.

Gjithashtu, për të miturit në konflikt me ligjin, në rastet e arrestimit, ata raportonin gjeneralitet në Komisaratin Krujë dhe shoqërohen menjëherë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të arrestuar/ndaluar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarati zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. U evidentuan rast pas rasti procedurat e ndjekura lidhur me dhënien e procesverbalit të shoqërimit për personat e shoqëruar në Komisaratin e Policisë Krujë.

Gjithashtu, grupi inspektimit u informua se karta e të drejtave i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar apo arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientet e Komisaratis duke garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

1. Marrjen e masave të nevojshme për rikonstruksionin e plotë të godinës së Komisaritit të Policisë Krujë, me qëllimin për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.
2. Marrjen e masave e menjëherëshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të dhomës së tretë të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Krujë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Procedurës Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe dinjitoz për të shoqëruarit.
3. Marrja e masave të menjëherëshme për plotësimin me saktësi të rubrikave të regjistrit nga punonjësit e policisë të këtij institucioni
4. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e tualeteve për personat e shoqëruar brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA

Konc. & Dak.
Hazbi Selita
Dak.
Besnik Deda